



VENDIM

Nr.76 Datë 24.07.2013

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVË PËR MODIFIKIMIN E LICENSËS
SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË
“SELCA ENERGJI” SH.P.K ME NR.102, SERIE PV10P, LESHUAR
ME VENDIM TE BORDIT TE KOMISIONEREVE TE ERE-S NR.39,
DT. 05.05.2010**

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të “Liçensës për Prodhimin e Energjisë Elektrike, si dhe nenet 10 dhe 15 pikat 1 dhe 2 germa “b”, pika 4, të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, dhe nenit 18 pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin Nr. 21, datë 18.03.2009, të Bordit të Komisionerëve, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 24.07.2013, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “SELCA ENERGJI” sh.p.k për ndryshimin e liçensës Nr.102, Seria PV10P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.39, datë 05.05.2010 dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatoi se:

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “SELCA ENERGJI” sh.p.k plotëson kërkesat e “Rregullores së procedurave të liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, si më poshtë:

- ***Neni 15, pika 4, germa “a”:***

Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e liçensës. (është plotësuar tërësisht)

- ***Neni 15, pika 4, germa “b”:***

Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të liçensuarit te cilat shprehin vullnetin për te kërkuar modifikim liçense. (është plotësuar tërësisht)

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e liçensës së shoqërisë “Selca Energji” sh.p.k me numër Nr.102, seria PV10P, për Prodhimin e Energjisë Elktrike nga Hec ‘ Selce’ me fuqi 400 KW, lëshuar me Vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.39, dt. 05.05.2010.
2. Ngarkohet Drejtorja e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI